


REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

Nr.Rend r	Data e kërkesës	Objekti I kërkesës	Përgjigje	Tarifa
1.	22.01.2025	Kërkesë për informacion	Per të marrëinformacionin e kërkuar të lutem shiko faqen zyrtare të ISHP dhe AKM.	Nuk ka
2.	03.02.2025	Kërkesë për informacion	1.A ka një datë zyrtare se kur Shqipëria doli nga gjendja e emergjencës kombëtare nën infeksionin e COVID-19? – 5 maj 2023 ëëë.ëho.org.int 2. Sa ishte numri total i rasteve të konfirmuara me COVID-19 në Shqipëri nga marsi 2020 deri në fund të gjendjes së emergjencës kombëtare nën infeksionin e COVID-19? - Deri në 25 prill 2023 nr i rasteve sipas buletinit javor, të dhënat e agreguara nga raportimet ishte: 310536 3. Sa ishte numri total i viktimave si pasojë e COVID-19 – ju lutem specifikoni si numër të përgjithshëm moshën, gjininë dhe qarkun ku kishin rezidencën, – dhe sa prej tyre ishin punonjës shëndetësorë (mjekë, infermierë, teknikë laboratorë, etj.) – ju lutem specifikoni si numër të përgjithshëm gjininë, moshën dhe vendin ku shërbenin? - Total vdekje sipas raportimeve të dërguara deri me datë 25 prill 2025, nga Buletini javor, ishte: 3625. 4. Në bilancin e pandemisë që bëhej publik gjatë periudhës së emergjencës kombëtare autoritetet raportonin vetëm të dhënat që referoheshin nga sistemi publik, pra spitalet publike, a është rishikuar bilanci zyrtar i pandemisë duke përllogaritur edhe numrin e qytetarëve të infektuar, të cilët u trajtuan apo humbën dhe jetën në spitale private dhe jashtë shtetit? Nëse po, sa ishte numri i këtyre personave, – ju lutem specifikoni si numër të përgjithshëm gjininë, moshën dhe qarkun kukishin rezidencën. - Pandemia e COVID 19 vijon pamvaresisht emergjencës. 5. Sa vaksina u administruan gjithsej – ju lutem specifikoni llojin e vaksinave dhe vendin e origjinës – dhe sa ishte përqindja e popullsisë së vaksinuar plotësisht – ju lutem specifikoni	Nuk ka

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

			si numër të përgjithshëm moshën, gjininë dhe qarkun e rezidencës së tyre, – në fund të gjendjes së emergjencës kombëtare nga infeksioni i COVID-19? - Vaksinimi i COVID 19 vijon ende, mbështetur ne rekomandimet e OBSH për një dozë vjetore ndaj COVID 19, sipas këkesës së popullatës.																																																																																																																									
3.	06.02.2025	Kërkesë për informacion	Rastet e reja me cancer te diagnostikuar gjate vitit 2023 <table border="1"> <thead> <tr> <th>Kanceri</th> <th>2023 (Meshkuj)</th> <th>2023 (Femra)</th> <th>2022 (Meshkuj)</th> <th>2022 (Femra)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>Të tjerë</td><td>194</td><td>151</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Pa specifikuar</td><td>40</td><td>82</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Lëkura**</td><td>710</td><td>873</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Esorfuq</td><td>34</td><td>12</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Melanoma</td><td>34</td><td>31</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Laringu</td><td>95</td><td>5</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Qafa e mbrës</td><td>0</td><td>110</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Gjaja buzet fytyr</td><td>86</td><td>32</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Mëlqja</td><td>73</td><td>44</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Veshika</td><td>70</td><td>54</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Mieloma</td><td>72</td><td>65</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Vezoret</td><td>0</td><td>126</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Pankreasi</td><td>80</td><td>79</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Prostata</td><td>180</td><td>0</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Linfomat</td><td>112</td><td>81</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Mitza</td><td>0</td><td>232</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Leukozat</td><td>181</td><td>106</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Tiruri</td><td>188</td><td>56</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Stomaku</td><td>237</td><td>94</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Fshikëza urthës</td><td>378</td><td>84</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Zorra e trashë</td><td>281</td><td>209</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Gjinë</td><td>0</td><td>744</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Mushkëri</td><td>567</td><td>150</td><td></td><td></td></tr> </tbody> </table> <i>Vetem te femrat. Ne 2023 dhe 2022 u diagnostikuan perkatesisht 15 dhe 12 kancere te gjirit te meshkujt</i> <i>**Nuk perfshihen melanomat</i> Rastet e reja me cancer te diagnostikuar cdo vit per periudhen 2015-2023	Kanceri	2023 (Meshkuj)	2023 (Femra)	2022 (Meshkuj)	2022 (Femra)	Të tjerë	194	151			Pa specifikuar	40	82			Lëkura**	710	873			Esorfuq	34	12			Melanoma	34	31			Laringu	95	5			Qafa e mbrës	0	110			Gjaja buzet fytyr	86	32			Mëlqja	73	44			Veshika	70	54			Mieloma	72	65			Vezoret	0	126			Pankreasi	80	79			Prostata	180	0			Linfomat	112	81			Mitza	0	232			Leukozat	181	106			Tiruri	188	56			Stomaku	237	94			Fshikëza urthës	378	84			Zorra e trashë	281	209			Gjinë	0	744			Mushkëri	567	150			Nuk ka
Kanceri	2023 (Meshkuj)	2023 (Femra)	2022 (Meshkuj)	2022 (Femra)																																																																																																																								
Të tjerë	194	151																																																																																																																										
Pa specifikuar	40	82																																																																																																																										
Lëkura**	710	873																																																																																																																										
Esorfuq	34	12																																																																																																																										
Melanoma	34	31																																																																																																																										
Laringu	95	5																																																																																																																										
Qafa e mbrës	0	110																																																																																																																										
Gjaja buzet fytyr	86	32																																																																																																																										
Mëlqja	73	44																																																																																																																										
Veshika	70	54																																																																																																																										
Mieloma	72	65																																																																																																																										
Vezoret	0	126																																																																																																																										
Pankreasi	80	79																																																																																																																										
Prostata	180	0																																																																																																																										
Linfomat	112	81																																																																																																																										
Mitza	0	232																																																																																																																										
Leukozat	181	106																																																																																																																										
Tiruri	188	56																																																																																																																										
Stomaku	237	94																																																																																																																										
Fshikëza urthës	378	84																																																																																																																										
Zorra e trashë	281	209																																																																																																																										
Gjinë	0	744																																																																																																																										
Mushkëri	567	150																																																																																																																										

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGGJIGJEVE PËR 2025

			 5472 5498 6325 6220 6326 4442 6036 6366 6691 2015 2016 2017 2018 2019 2020 2021 2022 2023 Kerkesa per vdekjet lutemi ti drejtohet INSTAT	
4.	06.02.2024	Kërkesë për informacion	Ju keni deklaruar se nga 1 janar 2023 dhe deri më datë 27.02.2025 keni marrë 46 kërkesa nga subjekte të interesuara për vlerësimin e vështirësisë në punë. Cilat subjekte kanë qenë këto? (Nëse nga 27.02.2025 dhe deri në ditën kur do jepni informacion ka ndryshime të numrit të kërkesave na e bëni me dije). Ju informojmë se nga data 1 Janar 2023 deri më 27 Shkurt 2025, Institucioni ynë ka marrë 46 kërkesa nga subjekte të interesuara për vlerësimin e vështirësisë në punë. Përsa i përket nominimit të subjekteve që kanë paraqitur këto kërkesa, theksojmë se ky informacion konsiderohet konfidencial dhe trajtohet si i tillë nga institucioni ynë. 2. Sa është afati maksimal kohor që ISHP duhet të bëjë një vlerësim të vështirësisë në punë nga data kur mbërrin kërkesa nga subjekti i interesuar? Koha për kryerjen e vlerësimit të shkallës së vështirësisë në punë varet nga disa faktorë, duke përfshirë natyrën e institucionit, ngarkesën e punës dhe fizibilitetet institucionale sipas prioriteteve të vendosura nga institucioni. <u>Maksimumi i afatit kohor është një muaj.</u>	Nuk ka

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGGJIGJEVE PËR 2025

			3. A ka ndonjë procedurë të standardizuar ISHP për mënyrën e vlerësimit të vështirësisë në punë dhe a mund të na jepni një kopje të origjinalit të dokumentit përkatës që është miratuar dhe është në fuqi? <u>Vlerësimi i shkallëve të vështirësisë kryhet bazuar në përcaktimet ligjore të përfshira në Ligjin nr. 326, datë 31 Maj 2023.</u> 4. Ju keni deklaruar se deri më datë 27.02.2025 ka 4 kërkesa në proces shqyrtimi për vlerësim të vështirësisë në punë. Deri në ditën që do jepni informacion, na bëni me dije nëse ky numër ka ndryshuar. Deri më datë 27 shkurt 2025, ishin 4 kërkesa në proces shqyrtimi. Aktualisht, numri i kërkesave të tilla ka ndryshuar dhe <u>është vetëm një kërkesë</u> për vlerësim të shkallës së vështirësisë në punë në proces shqyrtimi.	
5.	11.02.2024	Kërkesë për informacion	1. MSHMS nuk ka arsye të japë rekomandim për izolim të strukturave arsimore sic ju shpreheni në kërkesën tuaj. Nuk është paraqitur asnjë rast tjetër përvec rastit të konfirmuar. 2. Është kryer hetimi epidemiologjik nga Njvksh Durrës dhe është kryer profilaksia me antibiotikë për mbi 95 persona. Për këtë arsye mësimi duhet të vijoj e situata epidemiologjike po monitorohet. 3 . Njvksh njohin hapat e ndjekjes së cdo rasti të dyshuar apo të konfirmuar dhe si në raste të tjera janë ndjekur të gjitha hapat e duhura. Prinderit vertetë që mund të ndjejnë momente pasigurie, por nuk është situatë për panik, por duhet të ndjekin rekomandimet e strukturave shëndetësore. 4. Nuk ka raste të tjera. ISHP jo vetëm që ka ndjekur situatën me rekomandimet përkatëse me Njvksh Durres, por ka kryer dhe komunikimin mediatik mbi rastin në fjalë për të qartësuar situatën dhe për të zbehur pasigurinë e prindërve.	Nuk ka
6.	14.02.2025	Kërkesë për informacion	A ka Instituti i Shëndetit Publik në Shqipëri raporte që analizojnë ndikimin e ndryshimeve klimatike në shëndetin e popullatës, dhe nëse po, mund të më dërgoni një kopje të këtyre raporteve? Instituti I Shëndetit Publik ka kryer vitet e fundit disa analiza kuantitative mbi risqet shëndetësore të lidhura me ndryshimet klimatike. Rezultatet e këtyre analizave janë publikuar si në Komunikim e 4t e Shqiperise mbi Ndryshimet Klimatike https://ëëë.undp.org/albania/publications/fourth-national-communication-albania-climate-change	Nuk ka

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

			ne raportime brenda e jashte vendit: https://ëëë.interacademies.org/sites/default/files/2021-10/Tackling%20the%20effects%20of%20climate%20change%20on%20health%20in%20the%20Mediterranean%20and%20surrounding%20regions.pdf ne publikime te tjera me te fundit: https://academic.oup.com/eurpub/article/34/Supplement_3/ckae144.1353/7844463?login=false · Çfarë lloj sëmundjesh janë më të prekurat nga ndryshimet klimatike në Shqipëri? A ka ndodhur një rritje e rasteve të sëmundjeve të tilla vitet e fundit? Në përmbledhje risqet më të mëdha të lidhura me ndryshimet klimatike ne Shqipëri konsistojnë në: Rritja e riskut për vdekje të parakohëshme të personave të moshuar me sëmundje kronike kardiovaskulare gjatë valeve të nxehtit. Gjatë dy valeve të të nxehtit të marra në analize para pandemisë u vërejt rritje e riskut për të vdekur me 9%-36% për disa sëmundje kardiovaskulare, sidomos insuficiencën kardiake dhe goditjen cerebrale. Ritja e riskut për gastroenteritë me rritjen e temperaturave sidomos tek moshat nën 14 vjec. Probleme të tjera shëndetësore që do të ndikohen janë një sërë sëmundjesh infektive të shkaktuara nga agjentë të cilët po behen endemikë në Europën Jugore si pasojë e ngrohjes globale, hipertensioni, obeziteti, kequshqyerja, astma dhe alergjitë, depresioni etj. Grupet më të riskuara, vec të moshuarve dhe fëmijëve, sidomos në kushtet e emergjencave mjedisore do të jenë edhe personat me nevojë të veçantë. Personat që banojnë në qytete të mëdha do të jenë më të rrezikuar nga valët e të nxehtit, personat që banojnë në zonat rurale më të rrezikuar nga sëmundjet diarreike dhe katastrofat e shkaktuara nga zjarret dhe përmbytjet. · A ka masa të veçantë që janë marrë ose janë planifikuar për të adresuar pasojat e ndryshimeve klimatike në shëndetin publik, përfshirë informimin dhe edukimin e popullatës?	
--	--	--	---	--

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

		MShMS e kanë reflektuar shqetësimin e lidhur me ndryshimet klimatike në një sërë strategjish, politikash dhe nderhyrjesh për forcimin e sistemit shëndetësor. Ndryshimet klimatike janë adresuar në një dokument strategjik “Për përshtatjen e sistemit shëndetësor ndaj ndryshimeve klimatike” që në vitin 2011. Ndër synimet kryesore të kësaj strategjie janë; -fuqizimi i sistemit të urgjencave mjekësore në të gjithë nivelet e sistemit për të përballuar valët e të nxehtit dhe emergjencat nga moti ekstrem, -fuqizimi i sistemeve të survejancës epidemiologjike për sëmundjet infektive, -koordinimi më i mirë me strukturat e tjera në kushtet e emergjencave mjedisore, -rritja e ndergjegjesimit të profesionistëve dhe publikut, -si dhe rritja e efikasitetit energjitik të infrastrukturës shëndetësore. Vitet e fundit, risku i rritur për shëndetin nga ndryshimet klimatike është trajtuar sidomos në kontekstin e emergjencave me natyrë mjedisore. Janë një sërë dokumentesh politike që mbulojnë këtë prioritet: -Një plan i detajuar operacional mbi emergjencat është miratuar në 2020 (nr 71). -Në strategjinë e re të shëndetësisë të vitit 2021 të gjitha objektivat e qëllimit të politikës 4 i dedikohen emergjencave, përfshi koordinimin, sistemet e survejancës dhe komunikimin e riskut. Gjithashtu, objektivi specifik 9 I qëllimit politik 2 është “kontrolli i rezistencës antimikrobike”. -Plani kombëtar spitalor i vitit 2022 ka në fokus vec të tjerash edhe fuqizimin e shërbimeve të urgjencës mjekësore dhe paramjekësore për përballimin e cdo emergjence mjedisore, përfshi modernizimin e flotës së autoambulancave, kualifikimit të vazhdueshëm të stafit, transformimit të qendrës së koordinimit dhe ngritjen e qendrës back up në Vlorë për shkurtimin e kohës së përgjigjes. Ligji nr 147 I vitit 2014 mbi shërbimet mjekësore të urgjencës ka shërbyer si bazë për reformimin e sistemit të urgjencës 24/7 në të gjithë nivelet, krijimin e qendrës së re të urgjencës mjekësore dhe linjën telefonike unike kombëtare. Ky ligj ka rregulluar edhe shërbimet e urgjencës në kushtet e emergjencave apo fatkeqesive natyrore. Miratimi i ligjit	
--	--	--	--

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

			dhe dokumenteve të tjera rregullatore të lidhura me të është pasur me investime të rëndësishme në infrastrukturë dhe burime njerezore Ligji 45. Viti 2019 për mbrojtjen civile ka hedhur bazat për koordinimin efektiv të strukturave të shëndetësisë me sektorët e tjerë në kushtet e emergjencave me natyrë mjedisore. Ligji i për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive i vitit 2016 ka shërbyer si bazë për shumë nderhyrje dhe përmirësime të sistemeve të survejancës epidemiologjike, sistemit laboratorik dhe koordinimit ndërkombëtar në fushën e kontrollit të agjenteve infektive të ndikuar nga ndryshimet klimatike. Prej vitit 2015 MSHMS ka ndërmarrë një ndërhyrje masive për dezinfektimin e të gjitha pikave të nxehta, të identifikuara nga Instituti i Shëndetit Publik. Ndërhyrja është duke u zhvilluar dhe po trajton problemin në rritje të mushkonjave apo mizave të rërës, të cilat shërbejnë si vektorë për kushtet shëndetësore kërcënuese për jetën, si Malaria, Chikungunya dhe encefaliti nga virusi i Nilit Perëndimor. Në bashkëpunim me Qeverinë Zvicerane ka filluar një program afatgjatë i reformimit dhe fuqizimit të sistemit të menaxhimit të emergjencave në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor. · Si e vlerëson Instituti i Shëndetit Publik ndikimin afatgjatë të ndryshimeve klimatike në shëndetin e grupeve të caktuara vulnerabël, si të moshuarit dhe ata me sëmundje kronike? Kemi vlerësuar se valet e të nxehtit mund të jenë përgjegjëse për 300-400 vdekje shtese nga viti 2030, kryesisht të personat e moshuar me sëmundje të tilla si insuficienca kardiale dhe goditjet cerebrale. Për më shumë shih raportet · A mund të më ofroni të dhëna për efektet e mundshme të valëve të nxehtësisë dhe përhapjes së sëmundjeve të tjera, siç janë infeksionet e ujit dhe të ajrit, për shkak të ndryshimeve klimatike?	
--	--	--	---	--

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

			Kemi vlerësuar një rritje të riskut për semundjet diarreike te femijët me rreth 600/100000 raste te reja shtese për cdo 1 gradë celcius rritje të temperaturave të verës. Në skenarin e rritjes 1.5 gradë kjo nenkupton rreth 4800 raste të reja më shumë cdo vit. Për më shumë shih raportet	
7.	28.02.2025	Kërkesë për informacion	1. Sa raste meningiti janë identifikuar në Durrës që nga dhjetori i kaluar? Vetem dy raste jane raportuar meningit meninogkoksik nga Durresi. 2. Ka pasur rritje të rasteve të meningitit, si dhe një gjendje virale e rënduar këtë vit. Çfarë masash janë marrë? Jo nuk ka pasur rritje te rasteve me meningit meningokoksik. Infeksionet virale kane qene prezent si cdo sezon, informacionet mbi ecurine e hasjes se infeksioneve respiratore e gjeni ne detaje ne faq ëeb: ëëë.ishp.gov.al 3. Sa raste të diagnostikuara dhe sa vdekje nga meningiti akut ka pasur në Shqipëri gjatë 5 viteve të fundit? Nga raportimet e NJVKSH jane raportuar 7 raste meningit nga te cilet 5 raste jane te konfirmuar. 4. Cilat masa janë marrë për menaxhimin e rasteve të meningitit? Janë kryer të gjitha masat e duhura mbi hetimin e rasteve nga ana epidemiologjike si nga izolimi i rastit me meningokoksemi, në ndjekjen e profilaksise medikamentoze me antibiotik të kontakteve, monitorim i statusit febril për raste t mundshme, në dhënien e rekomandimeve mbi higjenizimin mjedisor të rregullt si dhe rekomandime e kujdes mbi higjenën respiratore. 5. Pse nuk u dezinfektua shkolla "Eftali Koçi", ndërkohë që u krye në gjimnazin "Leonik Tomeo" në dhjetor në Durrës?	Nuk ka

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

			Rekomandimet janë dhënë në lidhje me higjienizim korrekt në mënyrë sistematike. 6. Pse u shmang/nuk u bë asnjë deklaratë publike nga autoriteti shëndetësor (NJVKSH) në Durrës për të informuar prindërit dhe për të shmangur panikun që u përhap me shpejtësi dhe u reflektua në numrin e lartë të mungesave në shkollë? NJVKSH Durrës mund të japë përgjigje në lidhje me pyetjen tuaj, por theksoj që janë kryer të gjitha njoftimet e nevojshme për çdo aktor të përfshirë në hetimin epidemiologjik dhe në ndjekjen e masave. 7. Pse nuk u ndoq protokoli për informimin e publikut në këtë rast, pavarësisht insistimit nga ana e gazetarëve të Durrësit? Nuk ju kuptojmë pyetjen për çfarë protokolli e keni, publiku është informuar për çdo rast. 8. Ka një strategji për monitorimin dhe parandalimin e sëmundjeve infektive në shkollë? Ka udhëzues për ndjekjen epidemiologjike dhe parandalimin e sëmundjeve infektive. Po një plan për përmirësimin e protokolleve të sigurisë shëndetësore në shkollë në të ardhmen? Është kryer monitorimi situatës dhe janë marrë të gjitha masat për parandalimin e transmetimit të infeksionit. 9. A e rekomandon ISHP kryerjen e vaksinës kundër meningitit akut në moshat shkollore në këto kushte të shfaqjes së sëmundjes te adoleshentët? ISHP ka rekomanduar ndjekjen e profilaksisë medikamentoze me antibiotikë për të gjithë kontaktet për çdo rast të dyshuar me dhe për çdo rast të konfirmuar me meningit meningokoksik. Gjithashtu për grupe rrisht udhëtime në vendet me endemicitet të lartë ISHP rekomandon kryerjen e vaksinimit. Ky informacion është i rëndësishëm për të ofruar një pasqyrë të plotë dhe të saktë mbi këtë çështje dhe për të informuar publikun në përputhje me ligjin dhe të drejtat që kanë qytetarët për të kërkuar dhe marrë informacion nga autoritetet publike.	
--	--	--	---	--

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

8.	11.03.2025	Kërkesë për informacion	Në përgjigje të kërkesës suaj, të datës 11.03.2025, ardhur me e-mail pranë Institutit të Shëndetit Publik, me lëndë: “Kërkesë për informacion”, për sa kërkohet në shkresë sqarojmë se: Instituti i Shëndetit Publik nuk është institucioni përgjegjës për vlerësimin e ndotjes radioaktive në ujin e pijshëm, referuar VKM 379 dt 25.05.2016 për miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm” i përditësuar me VKM-në nr. 403, datë 19.6.2024.	Nuk ka
9.	12.03.2025	Kërkesë për informacion	Në përgjigje të kërkesës për informacion të Z. Ervin Postoli, drejtuar Institutit të Shëndetit Publik (ISHP), datë 12.03.2025, në lidhje me ndotjen akustike, bëjmë me dije se: <i>Përgjigje e pyetjes 1 dhe 2:</i> ISHP nuk realizon monitorim të ndotjes akustike në Shqipëri. <i>Përgjigje e pyetjes 3 dhe 4:</i> ISHP nuk ka detyrë ligjore monitorimin e ndotjes akustike, kjo referuar Ligjit Nr.9774, datë 12.7.2007 “PËR VLERËSIMIN DHE ADMINISTRIMIN E ZHURMËS NË MJEDIS” i ndryshuar në Ligjin Nr 50/2023 datë 22/06/2023 dhe Udhëzimit të Përbashkët Nr.2, dt.15.11.2023 “Për nivelin Kufi të Zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive ekonomike-shoqërore”, pika 4, 5, 6 dhe 7 ku janë të percaktuar institucionet që ngarkohen me matjet dhe monitorimin e ndotjes akustike.	Nuk ka
10.	16.03.2025	Kërkesë për informacion	Në vijim të kërkesës datë 16/03/2025, ju lutem gjeni më poshtë përgjigjen: 1. Kërkoj të më vihen në dispozicion të dhënat specifike që ISHP-ja ka mbledhur për përdorimin e lëndëve narkotike nga të miturit në 5 vitet e fundit në Republikën e Shqipërisë. Bashkëlidhur lutem gjeni studime lidhur me përdorimin e lëndëve narkotike nga të miturit: https://hbcs.org/publications/reports/spotlight-on-adolescent-health-and-well-being/ https://hbcs.org/publications/reports/a-focus-on-adolescent-substance-use-in-europe-central-asiaand-canada/ 2. Nga cilat burime specifikisht i mbledh ISHP-ja të dhënat në lidhje me të miturit dhe përdorimin e lëndëve narkotike? Instituti i Shëndetit Publik bashkëpunon me disa institucione partnere, të cilat konsiderohen aktorë me një ndikim në fushën e drogës. Këto institucione janë: Ministria e Brendshme, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, etj. 3. Me cilat organizata dhe institucione shtetërore bashkëpunon ISHP-ja në kuadër të problemeve shëndetësore të lidhura me konsumin e drogave? Instituti i Shëndetit Publik bashkëpunon me disa institucione e organizata të cilat kanë në fokus problemet shëndetësore të lidhura me konsumin e drogës, disa nga Institucionet që	Nuk ka

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGGJIGJEVE PËR 2025

			kemi patur bashkëpunim më të ngushtë janë: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Terza” Tiranë, Qendra “Teen Challenge Albania”, Qendra “Aksion Plus”. 4. Si ndikojnë të dhënat e mbledhura në formulimin e politikave dhe strategjive për parandalimin e përdorimit të lëndëve narkotike nga të miturit? Cilat janë ndërhyrjet e rekomanduara bazuar në këto të dhëna? Qëllimi primar është agregimi dhe analizimi i të dhënave në lidhje me prezencën e një fenomeni të tillë në vend dhe për hartimin ose rekomandimin në nivel qendror të masave për ndërhyrje. Të dhënat absolutisht që ndikojnë në dhënien e rekomandimeve, hartimin e politikave ndërhyrëse në lidhje me implementimin e masave për parandalimin e varësisë dhe abuzimit me substancat apo lëndët narkotike. 5. Çfarë tregon analiza e të dhënave për nevojat specifike të të miturit në lidhje me parandalimin dhe trajtimin e varësisë nga lëndët narkotike? Si i adreson ISHP këto nevoja në programet dhe nismat e saj? Instituti i Shëndetit Publik mbështetur në analizën e të dhënave por dhe studimeve me Fakultetin e Mjekësisë kryejnë fushata promovuese, ndërgjegjësuere në rrjete sociale e media vizive, në sesione komunikimi në sistemin parauniversitar për të orientuar moshën e mitur dhe adoleshentët mbi informacione shëndetësore shtesë mbi llojet e ndryshme të drogave drejt aktiviteteve të shëndetshme, zënien e kohës së lirë me aktivitete sportive, parandalimin e varësisë dhe abuzimit me drogat, efektet negative dhe efektet e dëmshme në shëndet.	
11.	24.04.2025	Kërkesë për informacion	Në rastin konkret cdo përgjegjësi është e Pushtetit Vendor në bashkëpunim për Drejtoritë Rajonale Mjedisore dhe Inspektoriatin Përgjegjës për Mjedisin.	Nuk ka
12.	07.05.2025	Kërkesë për informacion	Në vijim të komunikimit, ju informojmë se numri i kërkesave të ardhura mbi vlerësimin e shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë në shëndet vijon të mbetet i njëjti ashtu sikurse dhe ju është raportuar dhe listuar institucionet në shkresën paraardhëse. Nuk kemi asnjë rast refuzimi mbi vlerësimin e shkallës së vështirësisë dhe dëmshmerisë në shëndet. Detaje mbi strukturën dhe funksionet e: • Departamentit të Vlerësimit dhe Trajtimit të Rreziqeve • Sektorit të Shëndetit në Punë dhe Toksikologjisë Gjithashtu dhe rregulloren e brendshme të ISHP-së mund të gjenden në faqen zyrtare të Institutit të Shëndetit Publik (https://ëëë.ishp.gov.al/)	Nuk ka

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

13.	04.05.2025	Kërkesë për informacion	Në përgjigje të kërkesës suaj sqarojmë se: Referuar Ligjit Nr.10 138, datë 11.5.2009 Për Shëndetin Publik, Instituti i Shëndetit Publik mbështet Ministrinë e Shëndetësisë dhe strukturat rajonale të shëndetit publik, për realizimin e funksioneve dhe shërbimeve të shëndetit publik. - Çfarë roli luan Instituti në monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm? Referuar VKM 379 datë 25.05.2016 Për Miratimin e Rregullores “Cilësia e Ujit të Pijshëm”, monitorimi i cilësisë së ujit të pijshëm është nën përgjegjësinë e strukturës rajonale të shëndetit publik (sot Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor - NJVKSH), për të siguruar që uji i pijshëm në territorin e vet administrativ plotëson kërkesat e kësaj rregulloreje. Kontrolli i cilësisë së ujit të pijshëm në rrjetin shpërndarës të ujësjellësit në rreth kryhet në bazë të pikave të monitorit sipas një Akt-Marrveshje midis shoqërisë së Ujësjiellës Kanalizime dhe NJVKSH-së. - Raporte vjetore për cilësinë e ujit dhe shëndetin publik. Të dhënat vjetore mbi monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm nga NJVKSH-të e rretheve dërgohen pranë Institutit të Shëndetit Publik dhe referuar VKM 379 datë 25.05.2016 Për Miratimin e Rregullores “Cilësia e Ujit të Pijshëm” hartohet raporti vjetor kombëtar mbi cilësinë e ujit të pijshëm. - Si bashkëpunon Instituti me pushtetin vendor në lidhje me cilësinë e ujit? Secila NJVKSH bazuar në të dhënat e monitorimit ditor bashkëpunon me pushtetin vendor përkatës në varësi të problematikave në lidhje me cilësinë e ujit të pijshëm. -A është i pijshëm uji që mbërrin në Çezmat e qytetarëve shqiptarë sot, në dijeni të institucionit tuaj? Vlerësimin ditor të cilësisë së ujit të pijshëm në rrjetin shpërndarës (në bazë të pikave të monitorit sipas një Akt-Marrveshje midis shoqërisë së Ujësjiellës Kanalizime dhe NJVKSH-së) është nën përgjegjësinë e NJVKSH-ve të rretheve. -A ka pasur raste helmimi të qytetarëve nga uji i pijshëm nga viti 2005 deri në vitin 2025? (numri i rasteve dhe vitet përkatëse). Çfarë masash ka marrë institucioni juaj në këto raste? Nga viti 2016 deri në 2024 ka patur në total 7 shpërthime me natyrë hidrike. Janë kryer të gjitha rekomandimet respektive qoftë për strukturat shëndetësore, popullatë dhe Ujësjiellës Kanalizimeve sipas peshës së problematikës. -A ka pasur ankesa zyrtare nga qytetarë apo institucione të tjera publike dhe private për cilësinë e ujit viti 2005 deri në vitin 2025? Sa ankesa (numri dhe viti specifikisht). Si i trajtoni këto ankesa? Ankesat e qytetarëve për cilësinë e ujit të pijshëm ju drejtohen NJVKSH-ve të rretheve përkatëse të cilët janë nën varësi nga Drejtoritë Rajonale të Operatorit të Kujdesit Shëndetësor.	Nuk ka

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

14.	15.05.2025	Kërkesë për informacion	Në vijim të kërkesës së Ora News Nr. 54 gjeni lutem përgjigjet e kërkuara si më poshtë: Instituti i Shendetit Publik ka kryer hetim epidemiologjik të thelluar në bashkëpunimin me NJVKSH Gramsh. Hipoteza e ngritur nga grupi i punës në investigimin epidemiologjik lidhet me konsumimin e ushqimit të përbashkët në kopësht dhe mos ndjekja dhe respektimi i rregullores higjienosanitare të përgatitjes së ushqimit. Paraqitja e rasteve në urgjencën e Gramshit ka filluar me regjistrimin e tyre në datën 20.05.2025. 2. Në vijim të kërkesës së Ora Neës Nr. 56 gjeni lutem përgjigjet e kërkuara si më poshtë; Rastet e konfirmuara me salmonelozë për periudhën Janar-Dhjetor 2024 dhe Janar-Maj 2025 Viti Periudha kohore Raste total /konfirmuara 2024 JANAR-DHJETOR 45 2025 JANAR-MAJ 41 Fëmijë deri në moshën 14 vjeç VITI 2024 - 13 FEMIJE PERIUDHA JANAR-DHJETOR VITI 2025 -33 FEMIJE PERIUDHA JANAR-MAJ	Nuk ka
	Gjatë muajit qershor kanë ardhur kërkesa për informacion por kthimi i përgjigjes së tyre nuk ka qënë në kompetencë të institucionit tonë.			
15.	09.07.2025	Kërkesë për informacion	Sëmundjet respiratore kronike janë sëmundje që prekin mushkëritë dhe rrugët e frymëmarrjes. Disa nga më të zakonshmet janë sëmundja pulmonare obstruktive kronike (SPOK), astma dhe alergjitë respiratore dhe sëmundjet profesionale të mushkërive. Përveç duhanirjes si faktor rreziku kryesor, faktorë të tjerë rreziku përfshijnë ndotjen e ajrit, kimikatet dhe pluhurat në ambjentin e punës dhe infeksionet e shpeshta të rrugëve të poshtme të frymëmarrjes gjatë fëmijërisë. Sipas një vlerësimi ndërkombëtar, të kryer nga Global Burden of Diseases (GBD 2021), Shqipëria ka prevalencën më të ulët të sëmundjeve	Nuk ka

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

			respiratore kronike krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Sëmundjet respiratore kronike – GBD Compare, 2021, të dy gjinitë, e standartizuar sipas moshës, 2021, Prevalenca: Shqipëria – 5028 për 100,000 banorë. (Harta 1). Në grafikun 1 më poshtë, paraqitet prevalenca e sëmundjeve respiratore kronike në vendin tonë për 100,000 banorë për vitin 2023. Astma dhe sëmundjet pulmonare obstruktive kronike (COPD) kanë prevalencën më të lartë ndër të gjithë sëmundjet respiratore kronike. Në grafikun 2 më poshtë paraqiten nivelet e vdekshmërisë së standartizuar për moshën (SDR) dhe nivelet bruto të vdekshmërisë (CDR), për 100,000 banorë, në vendin tonë për periudhën 2018- 2023. Niveli i vdekshmërisë nga sëmundjet respiratore kronike në vendin tonë është në ulje, duke përjashtuar periudhën e pandemisë që shkaktoi pasoja për të gjitha grup sëmundjet në populate kudo në botë. Grafiku 2. Sipas vlerësimeve të kryera (GBD 2021), në vendin tonë, 22.79% e vdekjeve nga sëmundjet pulmonare obstruktive kronike janë atribut i ndotjes së ajrit. Grafiku 2. Sipas vlerësimeve të kryera (GBD 2021), në vendin tonë, 22.79% e vdekjeve nga sëmundjet pulmonare obstruktive kronike janë atribut i ndotjes së ajrit. Rekomandime Ndotja e ajrit përbën një nga sfidat më të mëdha mjedisore dhe shëndetësore të kohëve moderne. Rritja e urbanizimit, industrializimi i shpejtë, transporti i pakontrolluar dhe djegia e mbeturinave kanë ndikuar ndjeshëm në përqendrimin e cilësisë së ajrit në shumë qytete. Kjo ndotje nuk ndikon vetëm në mjedis por ka pasoja edhe në shëndetin e popullatave duke ndikuar në zhvillimin e një sërë problemesh shëndetësore: respiratore, kardiovaskulare, rritje të niveleve të vdekshmërisë nga këto probleme. Për zbutjen e ndotjes së ajrit rekomandimet kryesore janë: 1. Përmirësimi i transportit urban 2. Menaxhimi i ndotjes industriale 3. Monitorimi dhe kontrolli i ndotjes së cilësisë së ajrit 4. Ndërhyrje në bujqësi dhe djegie të mbeturinave 5. Përfshirja e publikut dhe edukimi i tij 6. Mbështetje në politika dhe legjislacion.	
16.	20.08.2025	Kërkesë për informacion	Persa i perket pikes nr. 1 te kerkese ju informojme se: Ndotja e ajrit zhvillohet në dy kontekste: ndotja e ajrit të brendshëm (shtëpiak) dhe ndotja e ajrit të jashtëm. Vlerësimi i përmasave të efektit në shëndet të ndotjes së ajrit në Shqipëri apo në Tiranë mund të kryhet vetëm duke bërë ekstrapolime mbi gjetjet e literaturës dhe supozime të arsyeshme bazuar në nivelin real të sëmundshmërisë apo vdekshmërisë nga sëmundje të lidhura me ndotjen e ajrit në Shqipëri. Instituti i Shëndetit Publik për kryerjen e këtyre analizave bazohet në disa burime informacioni lidhur me barrën e sëmundjeve në vend, si dhe në vlerësime të kryera nga	Nuk ka

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

			Institute of Health Metrics and Evaluation, që konsiderohet referencë ndërkombëtare në këtë fushë. Efektet në shëndet të ndotjes së ajrit të brendshëm apo të jashtëm lidhen me mekanizma biologjikë që cojnë në rritjen e riskut për tu prekur apo për të vdekur nga dhjetëra sëmundje, ndër të cilat më kryesoret janë, sëmundjet ishemike të zemrës, sëmundjet cerebrovaskulare, sëmundjet pulmore obstruktive kronike (SPOK, kanceri i mushkërive etj Niveli i standartizuar për moshën i vdekshmërisë që i atribuohet ndotjes së ajrit në Shqipëri vlerësohet të ketë rënë në mënyrë të qëndrueshme prej vitit 1990. Nga 215 vdekje për 100000 banorë në 1990 në vetëm 66 vdekje për 100000 banorë në vitin 2021 (niveli i standartizuar shërben vetëm për krahasime në kohë dhe hapësirë dhe nuk vlen për përlogaritjen e numrit real). Kjo ka ardhur kryesisht si pasojë e uljes së vdekshmërisë atribuuar në mënyrë specifike ajrit të brendshëm. Edhe ndikimi i ndotjes së ajrit të jashtëm duket se ka një përmirësim në dekadën e fundit pas një rritje në periudhën 2000-2010 Perqindja e vdekjeve atribuuar ndotjes së ajrit në Shqipëri vlerësohet të jetë më e lartë se në vendet e Europës Perëndimore por pak më e ulët se në vende të tjera të Ballkanit Perëndimor dhe shumë më e ulët se në vende të tjera të Mesdheut Lindor. Gjithsej vlerësohet se ndotja e ajrit të brendshëm dhe të jashtëm në Shqipëri është përgjegjëse për rreth 8,8% të të gjithë vdekjeve. Ky proporcion ka qenë 16,8% në 2010, 23, 7% në 2000 dhe rreth 25% në 1990. Për të përlogaritur numrin real të vdekjeve në Tiranë nga sëmundjet kryesore të lidhura me ndotjen e ajrit mund të aplikojmë proporcionet e vlerësuara të efektit dhe numrat e observuar të vdekjeve. Siç është theksuar me sipër, përlogaritja bazohet në ekstrapolime mbi gjetjet e literaturës dhe supozime të arsyeshme bazuar në nivelin real të sëmundshmërisë apo vdekshmërisë nga sëmundje të lidhura me ndotjen e ajrit në Shqipëri Nga analiza e 4 sëmundjeve kryesore si: aksidentet cerebrovaskulare, sëmundet ishemike të zemrës, sëmundjet pulmore obstruktive kronike (SPOK) dhe astma dhe kanceri i mushkrive, konfirmohet një ulje e vdekjeve atribuuar ndotjes së ajrit të brendshëm dhe të jashtëm nga viti 2019 në vitin 2024. Vitet e pandemisë janë përjashtuar nga analiza për arsye të efektit shumë të madh të Covid 19 në këto sëmundje. Per piken nr.2 te kerkese ju bejme me dije se: Bazuar ne ligjin 162/ 2014, PER MBROJTJEN E CILESISE SE AJRIT NE MJEDIS (ndryshuar me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020), Autoriteti kompetent per vleresimin e cilesise se ajrit ne mjedis eshte Agjencia Kombetare e Mjedisit.	
--	--	--	--	--


REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

17.	28.08.2025	Kërkesë për informacion	Në përgjigje të email tuaj ju informojmë si më poshtë: Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR), si organ rregullator në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR) si organ ekzekutiv i tij, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre mbështetur në ligjin nr.8025/1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", i ndryshuar, nuk disponon asnjë informacion zyrtar lidhur me kompaninë Rametal dhe veprimtarinë që ushtron apo ka ushtruar kjo kompani. Gjithashtu, ju informojmë se KMR dhe ZMR, nuk i është kërkuar nga asnjë institucion që të kryejë inspektim pranë subjektit Rametal, as për efekt hetimi. Në momentin që, KMR dhe ZMR do të ketë një informacion zyrtar mbi situatën e konstatuar nga agjencitë e huaja, siç dhe citohet në email, apo kërkesë nga institucionet ligjzbatuese për efekt hetimi, atëherë do të ndërmerren veprime nëse do të jetë e nevojshme, për të vijuar me inspektimin apo për të bashkëpunuar me institucionet përkatëse në vend për monitorimin e radioaktivitetit, në përputhje dhe me legjislacionin në fuqi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizues.	
18.	30.09.2025	Kërkesë për informacion	Ne vijim të kërkesës suaj për informim, ju bejme me dije informacionin si më poshtë për pikat që mbulon ISHP; 1-A ka kontroll ka mbi ushqimet që futen në institucionet arsimore? Nëse po, na tregoni me detaje si funksionon kontrolli. Nuk është kompetence e ISHP. 2-Sa raste helmimesh kolektive në shkolla, çerdhe dhe kopshte janë raportuar për pesë vitet e fundit, sipas viteve? Per periudhën kohore 2021–shtator 2025, janë identifikuar 2 Shpërthime me shkaktar etiologjik Salmonelozë spp. Sipas viteve:2023 në një Çerdhe femijesh, Maj 2025 shpërthimi në një kopsht femijesh. 3-Nga cilat zona/qarqe/vende janë këto raste përgjithësisht? NJVKSH Tirane,(Kamez), NJVKSH Gramsh. 4-Sa nga këto raste janë verifikuar ose janë konsideruar si helmime nga ushqimi? Shpërthimi në Çerdhe (Kamez) Nga investigimi epidemiologjik rezultoi se; Hipotezat janë në përputhje me shpërthime të tjera të Salmonelës ku burimi mbetet i panjohur. Në shpërthimet e mëparshme të Salmonelës në parashkollor, përhapja nga personi në person	Nuk ka


REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

			fillimisht u mendua të ishte një faktor, por higjiena e dobët midis stafit u gjet të ishte shkaku kryesor dyshojmë se praktikat e dobëta të higjienës midis stafit ka të ngjarë të kenë shkaktuar përhapjen e shpërthimit përmes rrugëve fekale-orale. Rastet e shpërthimit Gramsh. Nga investigimi epidemiologjik i kryer, hipoteza më e mundshme lidhet me konsumimin e përbashkët të ushqimit nga personat e prekur. Kjo hipotezë mbështetet në analizën e menuse ditore dhe të ushqimeve të konsumuara, ku identifikohen si të përbashkëta veza, mishi pulës dhe qumështi. _____ _____	
19.	20.11.2025	Kërkesë për informacion	Situata epidemiologjike e sëmundjeve jo të transmetueshme në Bashkinë Bulqizë ISHP monitoron situatën e sëmundjeve jo të trasmetueshme përmes monitorimit të incidencës së katër grup sëmundjeve kryesore, sëmundjet ishemike të zemrës, sëmundjet cerebrovaskulare, kanceret dhe diabeti, për të cilat ekzistojnë regjistra kombëtarë. Gjithashtu monitorohet edhe vdekshmëria nga këto sëmundje, të cilat përbëjnë shumicën dërmuese të shkaqeve të vdekjeve në vendin tonë. Niveli i Vdekshmërisë Profili i vdekshmërisë për Bulqizën ndjek profilin kombëtar me sëmundjet e qarkullimit të gjakut dhe tumoret dy shkaqet kryesore të vdekjeve, të ndjekura nga traumat/helmimet dhe sëmundjet e sistemit respirator. Vërehen megjithatë disa dallime me mesataren kombëtare, pra në përgjithësi niveli i vdekshmërisë në Bulqizë është më i ulët sesa mesatarja e vendit. Risku për të vdekur nga sëmundjet e qarkullimit të gjakut dhe nga kanceret është më i ulët se ai në nivel kombëtar, ndërsa risku për të vdekur nga traumat është pak më i lartë. Niveli i vdekshmërisë (/100000), për grup sëmundjet kryesore në bashkinë Bulqizë krahasuar me nivelet në nivel kombëtar 2024 (Burimi: INSTAT)	Nuk ka


REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGGJIGJEVE PËR 2025

			<table><tr><th>Rastet</th><th>Shqiperi</th><th>Bulqizë</th></tr><tr><td>Vdekjet gjithsej</td><td>~550.0</td><td>~550.0</td></tr><tr><td>Te tjera</td><td>49.4</td><td>29.8</td></tr><tr><td>Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë</td><td>198.8</td><td>190.1</td></tr><tr><td>Dëmtime traumatike dhe helmime</td><td>27.8</td><td>33.5</td></tr><tr><td>Sëmundje të aparatit të frymëmarrjes</td><td>18.2</td><td>18.6</td></tr><tr><td>Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut</td><td>489.1</td><td>402.6</td></tr><tr><td>Tumoret</td><td>141.1</td><td>100.6</td></tr></table> 0.0 100.0 200.0 300.0 400.0 500.0 600.0 ■ Shqiperi ■ Bulqizë Niveli i incidencës së sëmundshmërisë Në Bulqizë, incidenca e kancereve, sëmundjeve ishemike të zemrës (përfshirë infarktin e miokardit) dhe sëmundjeve cerebrovaskulare (përfshirë hemoragjitë cerebrale) është shumë e ulët se mesatarja kombëtare. Incidenca e diabetit në Bulqizë ka shfaqur luhatje të mëdha gjatë viteve 2014–2024, me kulm në vitin 2022 dhe rënie të ndjeshme deri në vitin 2024. Profili i prirjes në kohë të raportimit të rasteve të reja me këto sëmundje për periudhën 2014-2024 duket të jetë ndikuar shumë nga dy vitet e pandemisë. Më poshtë paraqiten grafikisht të dhënat lidhur me nivelin e incidencës së sëmundjeve të ndryshme. Niveli i Incidencës së Kancerit në Bulqizë (/100000), 2024	Rastet	Shqiperi	Bulqizë	Vdekjet gjithsej	~550.0	~550.0	Te tjera	49.4	29.8	Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë	198.8	190.1	Dëmtime traumatike dhe helmime	27.8	33.5	Sëmundje të aparatit të frymëmarrjes	18.2	18.6	Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut	489.1	402.6	Tumoret	141.1	100.6	
Rastet	Shqiperi	Bulqizë																										
Vdekjet gjithsej	~550.0	~550.0																										
Te tjera	49.4	29.8																										
Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë	198.8	190.1																										
Dëmtime traumatike dhe helmime	27.8	33.5																										
Sëmundje të aparatit të frymëmarrjes	18.2	18.6																										
Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut	489.1	402.6																										
Tumoret	141.1	100.6																										


REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025



Incidenca e Aksidenteve Cerebrovaskulare në Bulqizë (/100000), 2015-2024



REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025



REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

			 2014 2015 2016 2017 2018 2019 2020 2021 2022 136.4 108.5 123.2 120.7 153.3 107.6 68.7 127.4 257.3 Përgjigje për pyetjen 2: Nuk janë kryer analiza për ndotjen e ujit të pijshëm në këtë zonë, veçanërisht ato lidhur me kromin hekzavalent në të paktën 10 vitet e fundit. Përgjigje për pyetjen 3: Kontrolli mjekësor periodik për minatorët, nuk është në përgjegjësinë e Institutit të Shëndetit Publik. Gjithashtu, programet e rehabilitimit për personat që pësojnë aksidente në punë nuk janë në përgjegjësinë e Institutit të Shëndetit Publik.	
	Gjatë muajit Dhjetor nuk ka patur kërkesa për informacion			

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

[illegible]

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

[illegible]

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

[illegible]

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2025

--	--	--	--	--